

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“EURO SBS” shpk

Ne Tirane, sot me date **04 shtator 2018**, (dymije e tetembedhete), une i nenshkruari i meposhtem :

ROLAND KOKONOZI, atesia Xhevdet, i datelindjes 20.02.1980, lindur neQ. Pprenjas, Librazhd dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr.030149391 dhe me nr. personal I00220213G

*me cilesine e “Ortakut Themelues”, redaktoje kete akt themelimi, nepemjet te cilit deklaroje se me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “, me ndryshimet perkatese, ne ligjin “Per QKB”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoje shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **“EURO SBS “ shpk.***

KREUI

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“EURO SBS” shpk.**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **“EURO SBS” shpk**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”), e themeluar nga personi fizik i siperpermendur, i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **“EURO SBS” shpk**, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku I vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar

Neni 3


Selia

Shoqeria e ka seline ne **Rr: “Kopshti Botanik”, godine banimi, Zona kadastrale 8270, pasuria nr. 8/278+1-2, apartament, kati pare, Njesia Administrative Farke. Tirane.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, me vendim te Ortakur te Vetem te shoqerise.

Neni 4

Objekti



Ne fushen e tregtimit me pakice te karburanteve dhe vajrave lubrifikante, nafte, e derivatet e saj, gaz, import-eksporti, me shumice dhe pakice; te mallrave ushqimore, bujgesore e blegtorale, e tregtim te tyre me shumice e pakice, fruta perime, industriale, hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike, lendeve te perpunuara e te paperpunuara, te bimeve medicinale, punime druri e duralumini, ne fushen e ndertimeve civile industriale, rikonstruksione te ndryshme, prodhime e tregtim te materialeve te ndertimit, shfrytezim pyjesh, hapjen e bar bufeve, fastfood, restoranteve, ushtrim aktiviteti sportiv, terrene sportive, pikave te autoservisit, lavazhit, pjese kembimi, hotele, fshatrave turistike, moteleve si dhe agjensive per shitblerje, dhenie me qira te pasurive te tundshme dhe te patundshme, agjensive komisionere organizimi i transportit te udhetareve dhe te mallrave me mjete te komunikacionit ajror, tokesor dhe detar, celja e zyrave te agjensive turistike dhe te shitjes se biletave per udhetime brenda dhe jashte vendit me te gjitha llojet e e mjeteve, organizimi i sherbimeve, ndihme juridike, kurse profesionale per gjuhe te huaja, kompjuter dhe sekretari, shitje kancelarie, etj. Veprimtari ne fushen e ndertimit, investimit, projektimit dhe zbatimit te punimeve te ndertimit te objekteve civile, industriale, social-kulturore, import-eksport, tregeti me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale. Investim, zhvillim, zbatim ne fushen e krijimit te pasurive te paluajtshme, shitja, blerja, ndermjetesimi, dhenia me qira. Administrimi i bashkepronesise ne objekte, sherbime ne fushen e mirembajtjes dhe administrimit te prones se perbashket. Menaxhim dhe shperndarje te ujit te pijshem dhe largimit te ujrave te ndotura. Konsulence teknike, studim, projektim ne fusha te ndryshme si mjedisi, telekomunikacioni, ndertim etj. Sherbime transporti taksi. Tregtim, importim-eksportim mallrash etj. Veprimtari ne fushen e peshkimit, drejtim peshku. Menaxhim dhe ofrim sherbimesh bar, restaurant, te tregtimit dhe te ofrimit te sherbimeve te cateringut. - Shitje suveniresh, produkte artizanale te tradites dhe botime mbi 2 trashgimine kulturore etj. Ndertime civile rrugore, detare, punime dheu, sistemime, terracime terrenesh, ndertimi i objekteve publike e private si dhe rikonstruksionin dhe riparimin e tyre, montimin, projektimin dhe zbatimin, prodhim te materialeve te ndertimit dhe ne pergjithesi te te gjitha aktiviteve dhe sherbimeve qe lidhen me fushen e ndertimit. Ndertime e punime hidroteknike, punime restaurimi, punime karpeneterie, punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal dhe punime mirembajtje. Importim dhe eksportim, tregtim me shumice dhe pakice i cdo lloj malli te lejuar sipas legjislacionit shqiptare. Shoqeria mund te realizoje cdo lloje operacioni financiar apo tregtare qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj.

Import dhe tregetim me shumice e pakice te automjeteve te llojeve dhe tonazheve te ndryshme dhe pjeseve te kembimit per to. Servis automjetesh. Tregetim me pakice te karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Agjensi udhetimesh turistike. Veprimtari hoteliere, bar-bufe, restaurant.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II. KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100 000 lekë** dhe eshte i perbere nga **1 kuote**.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku i vetem i shoqërise perkatesisht :

ROLAND KOKONOZI, zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 100 000 Leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.



Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut te vetem mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Ortaku i vetem për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votimin e tij. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë është **Z. Roland Kokonozi**, *i cili do të ushtroje funksionet në këto detyre për një periudhë 5 vjetore me të drejtë ripërtëritje.*

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në cdo kohë :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këto statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem themelues te shoqerise tregtare "EURO SBS" shpk. i cili deklaroi se ka lexuar e kuptuar gjithcka ne lidhje me kete statut dhe e nenshkruan rregullisht ate ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij origjinale.

Ngarkohet _____, per depozitim te ketyre akteve prane QKB.

ORTAKU I VETEM

ROLAND KOKONOZI

Roland kokonozi
